



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Ref: 1305/690/BA/dk

VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA

në çështjen e Ankesës nga

IPKO TELECOMMUNICATIONN L.L.C

(“Pala ankuese”)

I përfaqësuar nga:

Znj. Zana Bejta-Udhëheqëse e Departamentit Ligjor
z. Robert Erzin- Drejtor Ekzekutiv i IPKO-s
znj. Blinera Osmani- Zyrtare Ligjore

kundër vendimit të
Komisionit të Pavarur për Media (“KPM”)

në ankesën 2012/187
(Vendimi i KPM-së i 28 dhjetor 2012)

Historiku dhe faktet

1. Me vendimin e tij të datës 28 dhjetor 2012 (Ref: 1301/009/KPM/nr) Komisioni ka shqiptuar gjobën prej 60,000.00 € kundër palës ankuese IPKO pers shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-se dhe për shkeljen e Rregullores për Distribuim Kabllor CIMC-2007/04.
2. Më 11 shkurt 2013, brenda afatit ligjor, pala ankuese ka parashtruar ankesë kundër vendimit sanksionues të Komisionit. Në këtë ankesë, IPKO pretendon se nuk është fajtores për faktin se ka ndjekur të gjitha procedurat për aplikim për licencë mirëpo deri me tani nuk është licencuar nga KPM-ja.
3. IPKO, me datën 8 gusht 2008, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Ankuese është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.

4. KPM-ja me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Ankuese me Ligjin e KPM-së, me datën 8 nëntor 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se ky operator në mënyrë të vazhdueshme është duke vepruar në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, pasi që në platformën e vetë kabllore bartë kanalet Super Sport 1 Kosova, Super Sport 2 Kosova, Super Sport 3 Kosova, Super Sport 1 Kosova HD, Super Sport 2 Kosova HD, Super Sport 3 Kosova HD të cilat nuk janë të licencuara në KPM.
5. KPM me qëllim të sqarimit të kësaj çështje me datën 23 gusht 2012, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar nga Pala Ankuese dëshmi për licencimin këtyre kanaleve qoftë edhe nga ndonjë shtet tjetër. Pala Ankuese me datë 28 gusht 2012, është përgjigjur ndaj kërkesës së KPM-së, duke potencuar se kanalet Super Sport Kosova nuk janë të licencuara në asnjë shtet tjetër e as në Kosovë, dhe ato bartën në platformën kabllore të IPKO-s, si kanale të palicencuara.
6. KPM-ja gjithashtu me datën 29 gusht 2012, përsëri nëpërmjet postës elektronike e ka njoftuar Palën Ankuese se bartja e kanaleve të palicencuara përbën shkelje të rend të Ligjit të KPM-së dhe se vazhdimi i bartjes se kanaleve të palicencuara mund të rezultojë me masën sanksionuese deri në shumën prej 100,000.00 euro.
7. KPM-ja bazuar në shkeljen e nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së nga ana e Palës Ankuese, me datën 14 nëntor 2012, i ka dërguar Njoftim për Shkelje nëpërmjet të cilit është udhëzuar që menjëherë të ndalon bartjen e kanaleve të shpërmendura deri në licencimin e tyre, në të kundërtën KPM-ja do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Ankuese për shkeljet e bëra.
8. KPM-ja serish me datën 21 nëntor 2012, ka bërë monitorimin e Palës Ankuese ku ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për Shkelje Pala Ankuese ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së.
9. KPM-ja duke u bazuar në shkeljet e vazhdueshme të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, me datën 26 nëntor 2012, i ka dërguar Palës Ankuese Vërejtje përmes së cilës i është bërë me dije së bartja e mëtutjeshme e kanaleve të pa licencuara do të rezultojë me masa sanksionuese kundër Palës Ankuese në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së.
10. KPM edhe pas Vërejtjes se dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Ankuese ku me datën 27 nëntor 2012, ka gjetur se Pala Ankuese në mënyrë të vazhdueshme ka bartur kanalet e pa licencuar përmes platformës së vete kabllore, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së.
11. Pala Përgjegjëse me datën 27 nëntor 2012, është përgjigjur ndaj vërejtjes së KPM-së, duke pranuar së ka bërë lëshim në drejtim të respektimit të Ligjit të KPM-së.

Seanca dëgjimore

12. Në seancën dëgjimore të mbajtur më 8 maj 2013, u paraqiten argumentet e njëjta nga të dyja palët. IPKO në veçanti theksoi se vendimi për dënim në shumë prej 60 mijë euro ka qenë i padrejtë për disa arsye: IPKO nuk ka qenë në dijeni për shkeljet që ka bërë për vendosjen e tri kanaleve në platformën e vet kabllore. IPKO shton se është tërhequr vërejtja nga ana e KPM-së dhe menjëherë ka ndërmarr hapa duke aplikuar për licencim të këtyre kanaleve.

13. Përfaqësuesit e KPM-se argumentuan se IPKO nuk posedonte licence për bartjen e kanaleve edhe përkundër faktit se disa here i është tërhequr vërejtja nga ana e KPM-se, se bartja e kanaleve pa licence përben shkelje të rëndë të Ligjit të KPM-se dhe se mos ndërprerje e tyre do të rezultojë me vendim sanksionues nga ana e Komisionit. IPKO edhe përkundër këtyre vërejtjeve ka vazhduar me bartjen e kanaleve pa licencë duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin e KPM-se.
14. Përfaqësuesit e IPKO-s kërkuan nga Bordi për Ankesa që ta hedhin poshtë Vendimin e KPM-së dhe IPKO-s t'i ipet një vendim qortues, sepse natyra e shkeljes nga ana e IPKO-s ka qenë e lehtë dhe nuk është dëmtuar askush.

Vendimi dhe arsyet

15. Bordi për Ankesa (BA) në seancën e datës 8 maj 2013, konstatoi se nuk kishte kontestim të fakteve, d.m.th. IPKO nuk ishte në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së për shkak se ka vazhduar t'i bart kanalet të palicencuara në platformën vet kabllore.
16. Në Ankesën e IPKO-së, kundër vendimit të Komisionit të datës 28 dhjetor 2012, nr. 2012/187, Ref. 1301/009/KPM/nr, i shqyrtuar nga Bordi i Ankesave me datën 8 maj 2013, Bordi konstatoj që shkelja e Ligjit të KPM-së dhe e Rregullores CIMC-200704, të pohuara nga KPM ishin të bazuara. Bordi pas shqyrtimit të argumenteve nga IPKO dhe KPM, nuk gjeti prova të reja që vendimi i Komisionit të ndryshohet, dhe si rezultat i kësaj vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni në vlerë prej 60,000.00 mijë euro. Bordi konstaton se kjo shumë e gjobës do të arrin efektin përmirësues të IPKO-së që në të ardhmen të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së, dhe Rregulloren CIMC-2007/04.

Rishikim procedural

17. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM-në.
18. Palët ndaj vendimit të Bordit për Ankesa mund të paraqesin kërkesë për shqyrtim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi.
19. Inicimi i shqyrtimit procedural nuk ndalon zbatimin e vendimit të Bordit për Ankesa të KPM-së.


Daut Krasniqi
Kryetar, Bordi për Ankesa



04. 06. 2013
data